



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.184/10.prot.

Tepelenë më, 01.02.2023

VENDIM

NR.10 . DATË. 31/01/ 2023

PËR DHËNIE TITULL NDERI

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 31/01/2023 , në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 54 pika “m” ; Ligjit 112/2013 “Për dekoratat , titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit të RSH” pasi shqyrtoi materialin e Komisionit Këshillimor të Bashkisë Tepelenë

V E N D O S I

A. Të miratojë dhënien e titujve të nderit si më poshtë:

- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. *Miltiadh M. Muçi* me motivacionin : **”Për veprimtarinë e tij shoqërore dhe atdhetare, kontributin në promovim të historisë shekullore të Leklit, të vlerave të mëdha të trashëgimisë kulturore të këtij vendbanimi të lashtë 2400- vjeçar”.**
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. *Haxhi Dede Edmond Brahimaj* me motivacionin ; : **“Për përkushtim në rolin e tij paqësor për Fenë Bektashiane , qytetar me virtyte dhe vlera të larta kombëtare, organizator I palodhur në transmetimin dhe mbrojtjen e vlerave më të mira atdhetare për Labërinë dhe Kombin Shqiptar”.**
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. *Kastriot Caushi* me motivacionin : **“Për përkushtimin maksimal dhe të sukseshëm në Teatër dhe Kinematografinë shqiptare, intelektual dhe guximtar me virtyte të larta për Tepelenën dhe mbarë Kombin Shqiptar”.**
- Të vlerësoj me titullin: “Qytetar Nderi” Z. *Astrit Ajdini (Pas vdekjes)* me motivacionin : **“Për përkushtimin maksimal në misionin fisnik të mësuesit, intelektual dhe qytetar me virtyte të larta në transmetimin dhe mbrojtjen e vlerave patriotike në rrethin e Tepelenës dhe më gjerë”.**

B. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsim Kulturës dhe Kujdesit Social.

C. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Valbona ÇELA
Miratuar me 13(trembëdhjetë) vota
Vota Pro 13(trembëdhjetë)
Vota Kundër -
Vota Abstenim -
Zbardhur me datë 01.02.2023.

KRYETAR
ELVIS SHEHU

